




ODA EKONOMIKE E KOSOVËS
KOSOVA CHAMBER
OF COMMERCE



ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inxhinjere Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit Nr. I faqes Bë. Stranica Nr. Pages	OIRK PRISHTINË / A
Nr. I Prot. Broj Prot. Prot. No. Data: Datum: Date:	899/25 04.11.25 No.1

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

i lidhur ndërmjet

ODA EKONOMIKE E KOSOVËS (OEK)

(përmes Shoqatës së Prokurimit të Bizneseve të Kosovës (ShPBK))

DHE

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OIRK)

Duke marrë parasysh rëndësinë e profesionalizmit dhe integritetit në realizimin e projekteve publike përmes prokurimit, nevojën për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Bizneseve anëtare të Shoqatës, rolin thelbësor të inxhinierëve të licencuar në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve publike, dhe bazuar në Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve, si dhe Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe aktet nënligjore përkatëse, Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë:

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Palët pjesëmarrëse:

Ky Memorandum lidhët me datën xx.10.2025, ndërmjet:

Odës Ekonomike të Kosovës (OEK)
(Shoqata e Prokurimit të Bizneseve të Kosovës (ShPBK))
Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtina – KOSOVË

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)
Adresa: Kompleksi Rilindja, Kontejneri nr. 3, Kati 2, 10000 Prishtinë

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit

Ky Memorandum ka për qëllim të vendosë një kuadër bashkëpunimi ndërmjet OEK-ut dhe OIRK për te:

- Kontribuar në zbatimin e plotë të dispozitave ligjore që ndërlidhen me pjesëmarrjen e inxhinierëve të licencuar në procedurat e prokurimit publik në sektorin e ndërtimit;
- Identifikuar dhe eliminuar kriteret diskriminuese apo të pajustificuara në dokumentet e tenderimit që nuk bazohen në ndonjë dispozitë ligjore apo akt nënligjor në fuqi
- Rritur transparencën, profesionalizmin dhe mbrojtjen e konkurrencës së ndershme në fushën e ndërtimit publik.
- Promovuar bashkëpunimin ndërinstytucional në fushën e prokurimit publik dhe të praktikave profesionale.
- Te forcuar zërin e sektorit privat dhe profesional në politikat e prokurimit publik.

Neni 2

Baza Ligjore

Ky Memorandum bazohet në:

- Ligjin Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit;
- Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik;
- Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtim;
- Statutin e Shoqatës së Prokurimit të Bizneseve të Kosovës;
- Aktet nënligjore përkatëse dhe udhëzimet administrative për prokurim dhe ndërtim.
- Ligjin për Odën Ekonomike të Kosovës (2004/7)
- Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit

Neni 3

Angazhimet e OIRK

Oda e Inxhinierëve angazhohet të:

1. Të publikojë (në ueb faqe të OIRK apo Ministrisë përkatëse) listën zyrtare dhe të përditësuar të inxhinierëve të licencuar sipas drejtimeve dhe specializimeve, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012;
2. Të bashkëpunojë me ShPBK-në në promovimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e udhëzimeve për autoritetet kontraktuese lidhur me kërkesat profesionale në dokumentet e tenderëve;
3. Të ofrojë këshilla ligjore dhe profesionale për shmangien e kriterëve diskriminuese që bien ndesh me kuadrin ligjor të aplikueshëm.
4. Të ofrojë ekspertizën profesionale dhe opinione teknike për dokumentacionet e tenderëve.

Neni 4

Angazhimet e Shoqatës së Prokurimit të Bizneseve të Kosovës

Shoqata angazhohet të:

1. Përcjellë shqetësimet dhe vërejtjet e anëtarëve të saj lidhur me barrierat apo kriteret diskriminuese në tenderë dhe t'i adresojë ato përmes bashkëpunimit me OIRK;

3. Të dyja palët angazhohen për mbështetje reciproke në proceset ku përfaqësohen interesat e anëtarëve të tyre.

Neni 8

Benefitet e Mundshme

1. Rritja e cilësisë së ofertave dhe dokumentacioneve në tenderët publikë.
2. Mbrojtja më e mirë e interesit të profesionistëve dhe bizneseve nga kriteret diskriminuese apo të pasakta në tenderë.
3. Krijimi i një platforme unike lobimi profesional që ndikon në ndryshimet ligjore dhe procedurale në prokurimin publik.
4. Rritja e atraktivitetit të Shoqatës së Prokurimit të Bizneseve, duke i demonstruar komunitetit të biznesit përfitimet e anëtarësimit dhe zërin e përbashkët në adresimin e sfidave të prokurimit publik

Neni 9


Kohëzgjatja dhe Rishikimi

Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe është i vlefshëm për tre (3) vjet. Çdo ndryshim apo rinovim do të bëhet me marrëveshje të ndërsjellë të palëve.

PALËT NËNSHKRUESE



z. Lulzim Rafuna
Kryetar i Odes Ekonomik te Kosoves



z. Arsim Rapuda
Kryetar i OIRK

Prishtinë, 04.11.2025

Adresa: Nëna Terezë, Nr:20, 10000 Prishtina – Kosovë
Tel: + 383 (0) 38 224 741, Tel & Fax +383 (0) 038 224 299
info@oek-kcc.org, www.oek-kcc.org

Kompleksi Rilindja , Kontejneri nr.3
Kati I 2-të , 10000 Prishtina , Kosovë
Tel:038/606 602 : info@oirk.org